

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Wit Korn Holding B.V., me seli në Pieter Baststraat 6H, 1071 TV Amsterdam, Holandë, MILIJA BABOVIQ, me vendbanim në Lackoviqeva 4, 11000 Beograd, Republika e Serbisë, dhe STEFAN BABOVIQ, me vendbanim në Jevrem Grujiq 24, 11000 Beograd, Republika e Serbisë, dorëzuar përmes Andrea Llazarevska, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 09.03.2026, solli këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Wit Korn Holding B.V., me seli në Pieter Baststraat 6H, 1071 TV Amsterdam, Holandë, MILIJA BABOVIQ, me vendbanim në Lackoviqeva 4, 11000 Beograd, Republika e Serbisë, dhe STEFAN BABOVIQ, me vendbanim në Jevrem Grujiq 24, 11000 Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojnë kontrollin e përbashkët mbi shoqërinë Dijamant SHPK Zrenjanin, me seli në rrugën Temishvarski drum 14, Zrenjanin 23000, Republika e Serbisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për iniciimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), më datë 30.01.2026, plotësuar më 02.02.2026, 09.02.2026, më 13.02.2026 dhe më 16.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e Wit Korn Holding B.V., me seli në Pieter Baststraat 6H, 1071 TV Amsterdam, Holandë, MILIJA BABOVIQ, me vendbanim në Lackoviqeva 4, 11000 Beograd, Republika e Serbisë, dhe STEFAN BABOVIQ, me vendbanim në Jevrem Grujiq 24, 11000 Beograd, Republika e Serbisë, me anë të të cilit të njëjtit do të fitojnë kontrollin e përbashkët mbi shoqërinë Dijamant SHPK Zrenjanin, me seli në rrugën Temishvarski drum 14, Zrenjanin 23000, Republika e Serbisë.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimet dhe shtojcat e tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Wit Korn Holding B.V është pjesë e grupit të shoqërive MK dhe është një shoqëri holding e cila është pjesë e divizionit të grupit MK aktiv në sektorin e bujqësisë. Funksionimi i shoqërive në kuadër të Grupit MK është i organizuar në pesë divizione: Divizioni i bujqësisë; Divizioni financiar, i cili përfshin operacionet bankare, të ndërmjetësimit (brokerimit) dhe të bursës; Hoteleria dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme; Divizioni i energjisë, i cili përfshin prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (era dhe biomasa); Divizioni i përbërë nga shoqëri operacionet e të cilave lidhen me ofrimin e mbështetjes afariste për të gjithë sistemin e grupit MK.

Grupi MK është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërisë së varur MK Suntastic SHPKNJP Shkup, dhe ka realizuar të hyra nga shitjet ndërkufitare të produkteve të mishit, perimeve të ngrira dhe sheqerit përmes shoqërive me seli në Serbi – PIK Beçej (*PIK Bečej*), Sunoko/Kristal Sunoko (*Sunoko/Kristal Sunoko*) dhe Karneks (*Carnex*).

Milija Baboviq është themeluesi dhe anëtari i vetëm i shoqërisë Fashion Company d.o.o. me seli në Bulevardin Mihajlo Pupin 115b, 11000 Beograd, Republika e Serbisë. Fashion Company është ndër kompanitë më të mëdha në Serbi që merren me modë dhe shitje me pakicë e shumicë të modës me më shumë se 100 objekte të shitjes me pakicë në Serbi dhe rajon (Mal i Zi, Maqedoni, Kroaci, Rumani).

Fashion Company është e pranishme në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërisë së saj të varur Eurofashion Trade SHPK Shkup, me seli në adresën Nikolla Klusev 6, kati i shtatë, Shkup - Qendër, Shkup, e cila kryen veprimtarinë e shitjes me pakicë të veshjeve në dyqane të specializuara.

Stefan Baboviq është anëtar kontrollues i shoqërisë SB Agro d.o.o. Beograd, Bulevardi Mihajlo Pupin 115b, 11000 Beograd, Republika e Serbisë. SB Agro është shoqëria mëmë e grupit të kompanive SB ("Grupi SB"). Aktivitetet afariste të Grupit SB kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave për prodhimin bujqësor, si me persona juridikë ashtu edhe me prodhues bujqësorë - nënkontraktorë, ferma bujqësore për kulturat e mëposhtme: elb, repkë (fara vajore), grurë, luledielli, sojë, panxhar sheqeri dhe misër. Grupi SB operon ekskluzivisht në territorin e Republikës së Serbisë.

Dijamant SHPK Zrenjanin është prodhues i vajrave ushqimore, margarinave, yndyrave bimore, majonezës dhe delikatesave me bazë majoneze, me seli në Serbi.

Dijamant SHPK Zrenjanin nuk ka shoqëri të varura, degë ose përfaqësi të themeluara në Maqedoninë e Veriut.

Dijamant SHPK Zrenjanin është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut me shitjen e vajt të lulediellit për ushqim, margarinës, margarinës për lyerje dhe majonezës.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ